



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 1055/4 Prot.

Tiranë, më 2/10/2013

Lënda: Rekomandim për "Dynamics Partners", Tiranë

REKOMANDIM

Nr. 26, datë 02/10/2013

Mbështetur në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr 211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe nr 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim-Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit,

KONSTATOVA

Nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit është zhvilluar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit, "Dynamics Partners" Tiranë me objekt:

- Masat lidhur me sigurinë e të dhënave personale (neni 27).
- Plotësimi i formularit të njoftimit (neni 21).

Nga kontrolli administrativ u konstatua se:

Kontrolluesi "Dynamics Partners" është kompani konsulencë për kërkim dhe përzgjedhje stafi menaxherial dhe strategji biznesi. Kontrolluesi ka një program specifik në të cilin regjistron të dhënat e kandidatëve si: emër, mbiemër, atësi, adresë e-maili, datëlindje, gjini, kombësi, qyteti i lindjes, shtetësi, adresa e banimit, nr. i telefonit, edukimi, gjuhët e huaja, njohurit kompjuterike, eksperiencia e punës. Të gjitha këto të dhëna kandidati aplikues i plotëson individualisht në sistemin e kompanisë "Dynamics Partners". Nga verifikimi që u bë në kompjuterin e kompanisë u konstatua se akses kishte vetëm specialistia e kërkimeve e cila kishte fjalëkalim personal. Kandidatët përpara se të aplikonin njiheshin me kartën e të drejtave të kandidatëve, e cila shfaqet në faqen zyrtare të kompanisë "Dynamics Partners". Në pikën 1 të kësaj karte është cituar shprehimisht se: *"kur kyni në listën e kandidatëve të Dynamics Partners, në një farë mase ju rrezikoni me punëdhënësin tuaj ekzistues. Për këtë arsye, ju sigurohet ruajtja e kofidencialitetit në nivelin më të lartë. Në mënyrë që të ruhet kofidencialiteti juaj, konsulenti i kërkimit të Dynamics Partners duhet: - Të marrë autorizimin tuaj para se t'ju prezantojë dhe t'i raportoje firmës kliente për ju. - Të kontaktojë direkt me ju gjatë procesit. - Të mos kontaktojë personat që kenë dhënë për referencë pa lejen tuaj. - Të mos diskutojë për mundësinë tuaj të punësimit me asnjë jashtë Dynamics Partners, dhe të sigurohet që të gjithë punonjësit tanë i binden të njëjtave rregulla. - Të kujdeset që edhe klienti të ruaj kofidencialitetin tuaj".*

Megjithëse në objektin e urdhërit të kontrollit administrativ nuk ishte e përfshirë dhënia e pëlqimit të subjekteve të cilëve ju përpunchen të dhënat personale si dhe informimi i tyre në

lidhje me qëllimin e përpunimit të të dhënave, meqenëse ky konstatim u bë gjatë kontrollit tek kontrolluesi, u la si detyrë që në kartën e të drejtave të klientit të përfshihet duke u cituar shprehimisht neni 6 pika a) ku përcaktohet se: *“Të dhënat personale përpunohen vetëm: a) nëse subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin”, dhe neni 18 i Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, i ndryshuar “Për mbrojtjen e të dhënave personale” ku përcaktohet se: “Kontrolluesi kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për personin që do t’i përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit, përveç rasti kur subjekti është në dijeni të këtij informacioni. Kontrolluesi duhet të informojë subjektin e të dhënave për të drejtën për akses, si dhe të drejtën për korrigjim të të dhënave të tij”.*

Gjithashtu gjatë kontrollit u konstatua se në ambientet e zyrës së kontrolluesit Dynamics Partners administroheshin në dosje të ndryshme të kandidatëve me testet e tyre. Në këto teste ishte i përfshirë emri dhe mbiemri i kandidatëve. Dosjet ruheshin në dollap të kyçur dhe derë me çelës ku akses kishte vetëm specialistia e kërkimeve. Këto dosje mbaheshin për një kohë të palimituar pasi qëllimi për të cilin mbledheshin nuk përfundonte, kjo pasi një kandidat që ishte testuar në një kohë të caktuar, mund të kërkohej nga kompania klient pas një ose dy vitesh, në momentin që hapej një pozicion i caktuar pune që kombinonte me interesat e kandidatit. U konstatua se në dosjet fizike të kandidatëve, ku ishin të përfshira testet e tyre, nuk kishte një akt informimi në lidhje me qëllimin për të cilin do të përpunoheshin të dhënat personale të kandidatëve. Ky akt informimi është i nevojshëm për ata kandidatë të cilët nuk kanë aplikuar online pranë kompanisë Dynamics Partners.

Në organikën e kontrolluesit Dynamics Partners ishin të punësuar dy punonjëse të dyja kishin të lidhur kontratë individuale pune. Në pikën 12 të kontratës ishte i përfshirë kofidencialiteti, konkretisht: *“Punëmarrësi do të ruaj kofidencialitet të plotë mbi informacionin e aktivitetit të punëdhënësit dhe ose drejtuesve të tij të cilin ai, ajo e disponon apo siguron për arsye të punës së tij; dhe dokumenta apo procese të cilat punëmarrësi i njej apo i krijon. Punëmarrësi nuk do të japë informacione apo dokumente të tilla palëve të treta, përveç kur kjo urdhërohet nga punëdhënësi dhe kur ai është i detyruar nga një gjykatë apo autoritet kompetent, gjatë periudhës së punësimit dhe as pas kësaj periudhe.....”.*

Edhe pse në objektin e urdhërit nuk ishte përfshirë kofidencialiteti, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit pranë kontrolluesit Dynamics Partners u konstatua që në kontratat individuale të punës ishte përfshirë kofidencialiteti mbi informacionin e kandidatëve. Në lidhje me kofidencialitetin, kontrolluesi duhet të shprehet në rregulloren e brendshme që do të hartoj në zbatim të nenit 28 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, i ndryshuar “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, ku përcaktohet se: *“Kontrolluesit, përpunuesit dhe personat, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë kofidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj.....”.*

Në lidhje me sigurinë e të dhënave nuk u konstatua ndonjë risk, pasi dollapi ku mbaheshin dosjet me testet e kandidatëve ishte i siguruar në një dhomë të mbyllur me kyç ku akses kishte vetëm specialistia e kërkimeve. Gjithashtu sistemi administrohej vetëm nga specialistia e kërkimeve me fjalëkalim të saj personal dhe nuk mund të hynte asnjë punonjës tjetër në këtë sistem për të aksesuar tek të dhënat e kandidatëve.

Gjithashtu u konstatua gjatë kontrollit administrativ dhe nga pyetjet që ju drejtuan specialistes së kërkimeve, se kontrolluesi nuk dispononte një rregullore të shkruar për mbledhjen, përpunimin, ruajtjen e të dhënave personale të klientëve, në zbatim të nenit 27 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Një objektivë tjetër e urdhërit të kontrollit administrativ ishte dhe plotësimi i detyrimit për të njoftuar pranë Komisionerit. Nga verifikimet që u bënë kontrolluesi figuronte me një emër tjetër, por pas kontrollit administrativ na vuri në dijeni me emrin e ri dhe u ribën verifikimet në zyrën e arkiv-protokollit pranë KMDP-së dhe u konstatua se ka njoftuar me një emër tjetër tregtar. Ju la si detyrë ndryshimi i emrit të kompanisë si dhe website-i.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pasi shqyrtoi pretendimet e kontrolluesit si dhe provat e administruara vëren se:

- Kontrolluesi “Dynamics Partners” nuk ka një rregullore të shkruar për mbledhjen, përpunimin, ruajtjen si dhe kofidencialitetin e të dhënave personale të klientëve, në zbatim të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” .
- Kontrolluesi “Dynamics Partners” ka të përfshirë në kartën e të drejtave të kandidatëve klauzolë mbi kofidencialitetin, por nuk ka të cituar shprehimisht nenin 6 1 a) të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”. në lidhje me dhënien e pëlqimit të kandidatëve për përpunimin e të dhënave të tyre si dhe nenin 18 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” në lidhje me të drejtën për t’i informuar ata në lidhje me qëllimin e këtij përpunimi.
- Të informohen në mënyrë të qartë, të plotë dhe të shprehur me anë të një akti kandidatët të cilëve ju mblidhen, përpunohen të dhënat personale për qëllimin/met e përpunimit, për kategorinë e të dhënave që mblidhen dhe përpunohen, për personin apo personat që do ti përpunojnë të dhënat, për mënyrën sesi do të përpunohen të dhënat dhe të drejtat e subjektit për të pasur akses apo për ti korigjuar ato, bazuar dhe në zbatim të nenit 18 pika 1) të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”;
- Kontrolluesi nuk ka bërë ndryshimet përkatëse në adresën e web-site-it si dhe ndryshimin e emrit tregtar të kompanisë.

Konstatimet e sipërme përbëjnë shkelje administrative të:

- **Neni 27 pika 2/1 i Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**

“Kontrolluesi është i detyruar të dokumentojë masat teknik-organizative të përshtatura dhe të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale , në përputhje me ligjin dhe rregullore të tjera”

- **Neni 28 i Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**

“Kontrolluesit, përpunuesit dhe personat, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë kofidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj.....”.

- **Neni 18 pika 1 e Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**

“kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin,.....”.

- **Neni 6 pika 1 a) e Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**

“Të dhënat personale përpunohen vetëm: a) nëse subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin”.

Për sa më sipër:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative ;

REKOMANDOJ

- 1- Në zbatim të neneve 27, 28 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të merren masa për hartimin e një rregullore të shkruar për mbledhjen, mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen si dhe konfidencialitetin e të dhënave personale. (Rregulloren tip mund ta gjeni në faqen zyrtare www.kmdp.al, si dhe ofrojmë asistencën tonë).
- 2- Kontrolluesi duhet të citoj shprehimisht tek karta e të drejtave të kandidatëve nenin 6 pika 1 a) të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në lidhje me dhënien e pëlqimit të kandidatëve për përpunimin e të dhënave të tyre si dhe nenin 18 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në lidhje me informimin e kandidatëve për çëllimin e përpunimit të të dhënave të tyre nga kompania Dynamics Partners në mënyrë të shprehur.
- 3- Kryerja e këtyre detyrimeve të rëndësishme të kryhet brenda një afati kohor prej 45 (dyzet e pesë) ditësh, nga momenti i marrjes dijeni të këtij rekomandimi.
- 4- Me plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionierit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- 5- Me kalimin e këtij afati në rast mospërbushje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, sipas të cilit *“Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave”.*

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

